



Lajme



Gazeta Express

12/01/2022 10:17

Me i fundit



Skandali/ "Kosi me fekalë" tregtohet në supermarkete, AKU hesht



Kapen me armë e thika, disa qytetarë të intervistuar në 24 orët e fundit



Policia e Kosovës ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë identifikuar disa raste të armëmbajtjes pa leje në disa komuna në Kosovë, shkruan Gazeta Express.

Në Prishtinë, është arrestuar një person pasi që gjatë kontrollit atij iu gjet një thikë.

Lexo Edhe:

"Rr. Nazim Gafurri, Prishtinë 11.01.2022-13:00. Njësitë patrullues ka ndaluar një veturë dhe gjatë kontrollit tek i dyshuari mashkull kosovar ka gjet dhe konfiskuar një thikë. Me vendim të prokurorit i dyshuari pas intervistimit lirohet në procedurë të rregullt", thuhet në raportin e policisë.

Ndërsa në Lipjan është arrestuar një person pasi në rrjete sociale postoi armë të llojit AK-47. I dyshuari me vendim të prokurorit është dërguar në mbajtje.

"Fsh. Akllap, Lipjan 11.01.2022-12:55. Njësitë hetuesisë ka identifikuar të dyshuarin mashkull kosovar i cili në rrjete sociale kishte postuar një AK-47. Është bastis shtëpia e të dyshuarit por nuk është gjet asgjë e dyshuar. Me vendim të prokurorit i dyshuari dërgohet në mbajtje", thuhet në njoftim.

Në ndërkohë, në fshatin Tërnavë është arrestuar një person pasi dyshohet se ka gjuajtur me armë zjarri natën e Vitit të Ri. Atij policia i gjeti një armë AK-47.

"Fsh. Tërnavë, 31.12.2021-00:12. Është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar pasi i njëjti në datën e cekur kishte shtënë me armë zjarri. Gjatë kontrollit në shtëpinë e të dyshuarit është gjetur dhe konfiskuar një armë AK-47. Me urdhrë të prokurorit i dyshuari është liruar, rasti vazhdon në procedurë të rregullt", thuhet në njoftim.

Edhe në fshatin Gjinovc të Suharekës policia ka intervistuar një person i cili pranoi se ka gjuajtur me armë gjatë festës së Vitit të ri.

"Fsh.Gjinoc, Suharekë Njësitë i hetuesisë ka identifikuar të dyshuarin mashkull kosovar i cili gjatë festës së vitit të ri ka shtënë me armë zjarrit në ajër. I dyshuari gjatë intervistimit ka pranuar se ka gjuajt me armë. Pas informatave të grumbulluara janë identifikuar edhe dy të dyshuar tjerë meshkuj kosovarë. Lidhur me rastet janë gjet dhe konfiskuar tri revole. Me vendim të prokurorit rasti shkon në procedurë të rregullt", ka njoftuar policia.

Ndërsa në Mamushë policia poashtu identifikoi një person që gjatë festës së Vitit të ri shtiu me armë zjarri.

"Mamushë 31.12.2021-23:40. Njësitë hetuesi ka identifikuar të dyshuarin mashkull kosovar i cili gjatë festës së vitit të ri ka shtënë me armë zjarrit në ajër. Nga i dyshuari janë konfiskuar një pushkë gjuetie dhe një revole. Me vendim të prokurorit pas intervistimit rasti shkon në procedurë të rregullt", ka njoftuar policia.

Ndërkaq në Malishevë janë arrestuar dy nxënës të mitur, pasi gjatë kontrollit u janë konfiskuar tri thika.

"Rr. Habib Berisha, Malishevë 11.01.2022-10:10. Raportohet se janë arrestuar dy meshkuj kosovarë, të mitur nxënës të shkollës profesionale, pasi që gjatë kontrollit iu janë gjet dhe konfiskuar tri thika. Me vendim të prokurorit pas intervistimit të dyshuarit janë liruar në procedurë të rregullt", thuhet në njoftim. /Express/

Share Now



Te fundit



Skandali/ "Kosi me fekalë" tregtohet në supermarkete, AKU hesht




Super Fati, rikthehet me gol në një super gjysmëfinale të El Clasicos



Lautaro me gol të bukur nga penalltia barazon rezultatin



Bisedimet NATO-Rusi, palët ende nuk pajtohen për uljen e tensioneve në Ukrainë



Nuk fal Benzema, kalon Realin në epërsi



Gorani: Njohja nga Serbia s'është e rëndësishme, por njohja nga OKB'ja po